



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 99, Datë 12.05.2025

MBI

**LICENCIMIN E SHOQËRISË “NAD INVESTMENT” SH.P.K. NË VEPRIMTARINË E
FURNIZIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, gërma “d”, nenit 39, pika 4 të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; neneve 4, pika 1, gërma “a”, 5, pika 1, gërma “e”, 13, dhe 14, pika 9 të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar; si dhe nenit 15 dhe të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 12.05.2025, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1409/7 prot., datë 08.05.2025, të Drejtorisë së Licencimit dhe Autorizimeve “Mbi kërkesën e shoqërisë “NAD Investment” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike”,

Konstatohet se:

- Shoqëria “NAD Investment” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1409 prot., datë 25.03.2025, ka paraqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike.
- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 70, datë 08.04.2025, vendosi të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë në këtë veprimtari.
- ERE botoi njoftimin në median e shkruar për fillimin e procedurës (në datat 09.04.2025 dhe 10.04.2025) dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo objeksioneve nga të tretët (data 18.04.2025), nuk rezultoi të ketë të tilla. Njoftimi për fillimin e procedurës u botua edhe në faqen zyrtare të internetit të ERE-s.
- Me shkresën nr. 1408/3 prot., datë 15.04.2025, ERE ka njoftuar shoqërinë për këtë vendim, duke evidentuar dhe informacionin/dokumentacionin e munguar të këtij aplikimi.
- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1408/4 prot., datë 25.04.2025, shoqëria ka depozituar dokumentacionin plotësues, nga shqyrtimi i të cilit ka rezultuar se ka ende informacion/dokumentacion që nevojitet të plotësohet, ndaj ERE iu drejtua shoqërisë me shkresën nr. 1409/4 prot., datë 30.04.2025.

- Kjo shkresë është kthyer mbrapsht nga shërbimi postar, ashtu sikurse dhe e-maillet që rezultojnë nga dokumentacioni i aplikimit të shoqërisë, të cilat i është dërguar një kopje e skanuar e shkresës së lartpërmendur. Si e tillë dhe pasi kontaktit nëpërmjet telefonit, kjo shkresë i është dërguar e skanuar shoqërisë nëpërmjet një e-mailit të ri të dhënë nga përfaqësuesi i shoqërisë.
- Në përgjigje, në datën 07.05.2025, shoqëria ka dorëzuar në ERE të gjithë dokumentacionin e kërkuar, duke plotësuar në tërësi aplikimin për licencim.
- Sa i përket strukturës organizative, nga dokumentacioni i dorëzuar rezulton se shoqëria ka parashikuar një strukturë të detajuar dhe funksionale, që mbulon përgjegjësitë teknike dhe operative për veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike. Në këto kushte, vlerësohet t'i lihet kusht që shoqëria me fillimin e operimit të depozitojë në ERE strukturën organizative të përditësuar me stafin teknik të brendshëm.
- Shoqëria ka paraqitur në ERE parashikimin e sasisë së energjisë elektrike që synon të furnizojë gjatë pesë viteve të vlefshmërisë së licencës. Ka bërë me dije mbi Sistemin e IT-s që do të operojë veprimtarinë e furnizimit dhe faturimit, si dhe ka dhënë informacion mbi nivelin e tensionit dhe mënyrën e realizimit të matjes për klientët të cilët do të furnizojë.
- Rezulton se aktualisht shoqëria ka një kontratë huapërdorje për disponimin e zyrave përfaqësuese të furnizuesit, me afat deri në 13.02.2030, që nuk mbulon të gjithë afatin e licencës dhe ka marrë angazhimin për njoftimin e ERE-s në rast ndryshimit të adresës dhe të rinovimit të kontratës. Në këto rrethana vlerësohet t'i lihet kusht që brenda datës 13.02.2030, të depozitojë në ERE kontratën e rinovuar, ose një dokument në lidhje me disponimin e zyrave për periudhën e mbetur të licencës.
- Në përfundim, vlerësohet se shoqëria ka përmbushur kushtet për licencim, me detyrimin për të respektuar afatet dhe detyrimet e përcaktuara.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të licencojë shoqërinë “NAD Investment” sh.p.k. në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, për një afat 5-vjeçar.
2. Me fillimin e operimit, të depozitojë në ERE strukturën organizative të përditësuar me stafin teknik të brendshëm.
3. Brenda datës 13.02.2030, shoqëria duhet të depozitojë në ERE kontratën e rinovuar të huapërdorjes për përdorimin e zyrave përfaqësuese të furnizuesit ose një dokument në lidhje me disponimin e tyre për periudhën e mbetur të licencës.
4. Ky vendim është objekt rishikimi në rast të përmbushjes apo mospërmbushjes së kushteve të përcaktuara në pikat 2 dhe 3 të këtij vendimi.

5. Drejtoria e Licencimit dhe Autorizimeve, të njoftojë shoqërinë “NAD Investment” sh.p.k., OST sh.a. dhe ALPEX sh.a., për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit AHMETI